



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 44

Prishtinë, më 16.03.2012, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Rexhep Selimi, Goran Marinković, Anton Quni, Fatmir Xhelili, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Emin Gërbeshi

Mungoi: Ahmet Isufi

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit të mbajtura më 02.03.2012;
3. Shqyrtimi i Raportit të Inspektoratit Policor të Kosovës lidhur me ngjarjet e datës 14.01.2012;
4. Të ndryshme.

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.*

1. Miratimi i Rendit të ditës

Nënkryetari i Komisionit, Rexhep Selimi- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të mbajtura, më 02.03.2012

Nënkryetari i Komisionit- Konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 02.03.2012 me vërejtjet e z. Fatmir Xhelili.

3. Shqyrtimi i Raportit të Inspektoratit Policor të Kosovës lidhur me ngjarjet e datës 14.01.2012

Nënkryetar i Komisionit- Ju njoftoj që kemi marrë Raportin e Inspektoratit Policor në bazë të kërkesës sonë që para datës 13 janar të sillet, dhe ky Raport ka ardhur dy ditë para këtij afati të caktuar.

Krahas Raportit për ngjarjet e 14 janarit, kemi edhe një Raport mbi hetimin e një rasti të hetuesit të Inspektoratit Policor i përfshirë në protestën e 14 janarit në Merdare. Paralel me këtë Raport, kemi edhe një Raport që e ka bërë zyra e Ombudspersonit të Kosovës.

Si anëtar i Komisionit do të jap një vlerësim të shkurtër për këtë Raport. Raporti është voluminoz dhe gjithëpërfshirës dhe nga kjo duket që i ka dhënë ose marrë Raportet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, kjo për shkak të dhënave që i referohet ky Raport.

Ajo çfarë nuk kam gjetur në këtë Raport është se, përderisa ky Raport i nxjerr disa raste individuale për veprimet, pika 3.6 në Raportin e Inspektoratit Policor, “veprimet hetimore të Inspektoratit Policor të Kosovës, pas ngjarjeve të 14 janarit, janë identifikuar disa raste” këto raste i referohen atyre që kanë ndodhur gjatë protestës por nuk janë përfshirë rastet gjatë shkuarjes ose kthimit, pasi për këtë ka pasur ankesa të shumta. Gjithashtu Raporti nuk fokusohet tek eprorët që kanë dhënë urdhër, por tek policët.

Mendoj që në këtë Raport mungon analizimi dhe raportimi për të gjithë atë çfarë ka ndodhur gjatë transportit të të arrestuarve dhe gjatë mbajtjes së tyre në stacionet policore, ku për këtë ka pasur ankesa dhe shkelje serioze sidomos gjatë mbajtjes dhe trajtimit të arrestuarve gjatë transportit dhe në stacionet e policisë.

Përveç këtij Raporti, kemi edhe Raportin për rastin e përfshirjes së hetuesit të Inspektoratit Policor i përfshirë në protestën e 14 janarit, gjithashtu në njërin nga mbledhjet e Komisionit e kemi trajtuar përfshirjen e një inspektori të Inspektoratit Policor në arrestim, gjë që nuk është në përputhje me detyrat që ka si pjesëtar i Inspektoratit Policor.

Gjithashtu nga Inspektorati Policor kemi kërkuar edhe një Raport për të parë se deri ku kanë arritur hetimet ndaj këtij pjesëtari për tejkalimin e përgjegjësisë së tij. Ne kemi pranuar një Raport të nënshkruar nga Drejtori i Departamentit të Hetimeve të Inspektoratit Policor me datë, 09.03.2012, ku masa e marrë ndaj këtij Inspektori të përfshirë në arrestim është citoj Raportin” zyrtarit *Qerim Bytyqi i shqiptohet masa e trajnimit të detyrueshëm siç parasheh neni 17 i udhëzimit administrativ*” pra masa që është marrë ndaj këtij Inspektori, i cili ka bërë shkelje të rregullores së punës, masa ndaj tij është trajnim i detyrueshëm.

Kjo masë nuk është në përputhje me atë se çfarë Inspektori i Inspektoratit Policor ka bërë, por përkundrazi mund të konsiderohet si shpërblim që i jepet atij. Konfirmoj që i kemi marrë të dy Raportet nga Inspektorati Policor i Kosovës dhe pres kontributin tuaj për analizimin e këtyre Raporteve.

Nga ky takim nuk do të dalim me rekomandime, pasi bazuar edhe në planin e veprimit Komisioni do të mbikëqyrë zbatueshmërinë e ligjit nga Inspektorati Policor i Kosovës, prandaj rekomandimet mund të jepen në ditët në vijim. Tani kërkoj nga anëtarët e Komisionit kontributin për analizimin e Raporteve.

Fatmir Xhelili- Raporti i Inspektoratit Policor për menaxhimin e protestave të Lëvizjes Vetëvendosje është një raport i detajuar dhe që i përshkruan ngjarjet në mënyrë kronologjike duke evidentuar qëllimet e menaxhimit të policisë për këtë situatë. Këto qëllime ishin, siguria e përgjithshme e vendit, siguria e kalueshmërisë së rrugëve nacionale dhe menaxhimi i protestave. Në Raport theksohet se protestat ishin të pa paralajmëruara dhe se gjatë protestës kanë shkelur ligjet në fuqi siç janë, rendi dhe qetësia publike, kalueshmëria e lirë e rrugëve.

Duke marrë parasysh numrin e madh të protestuesve dhe numrin e madh të policëve që kanë marrë pjesë në dy operacione të ndara të zhvilluara në të njëjtën ditë, në këso situata mund edhe të pritet ndonjë raste ku mund të ketë tejkalim të përdorimit të forcës.

Raporti përshkruan rastet e tejkalimit të forcës dhe masat e ndërmarra për personat të cilët kanë tejkaluar kompetencat për menaxhimin e situatave të 14 janarit. Për të gjitha këto raste shkojnë masa administrative dhe se zyrtarët policor që kanë tejkaluar kompetencat do të japin përgjegjësi para organeve përkatëse si dhe masa të tjera siç është edukimi dhe trajnimi shtesë për këta pjesëtar.

Mendoj që Policia duhet vlerësuar për punën e bërë por nuk pajtohem me tejkalimin e autorizimeve nga zyrtarët policor, dhe se numri i tyre është i vogël. E rëndësishme është që është bërë identifikimi i tyre dhe masat që do të ndërmerren do të jenë edukuese që në raste të tjera një gjë e tillë të mos përsëritet.

Inspektorati Policor është në fazën e përpilimit profesional, transformimit ku nga përgjegjësit e hetimeve administrative tani do të merret me hetimet penale dhe gjatë kësaj faze mund të paraqite edhe vështirësi në funksionim.

Anton Quni- Duke qenë se kemi një Raport të një mekanizmi që kontrollon performancën e Policisë së Kosovës është inkurajues, analiza mund të vlerësohet si reale nisur nga ajo që Inspektorati ka vlerësuar proceduar e marra nga momenti kur Policia e Kosovës e ka poseduar informatën për mbajtjen e Protestës, mënyrën e analizimit të rrezikshmërisë dhe parashikimit, vlerësim tjetër i bërë nga Inspektorati është edhe mënyra se si është menaxhuar me personelin policisë së Kosovës, shpërndarja e tyre, vetëdijesimi për përgjegjësitë që kanë, menaxhimi me mjete dhe materiale.

Rekomandimet e nxjerra nga Inspektorati Policor do ti hyjnë në punë Policisë së Kosovës për performancën e saj në situata të tilla. Duhet vlerësuar fakti që janë marrë parasysh faktet e mbledhura në terren por edhe nga prezenca e Inspektoratit Policor në këto protesta. Në pamundësi për të qenë i pranishëm në çdo pjesë mund të ketë ndonjë rast që ka ikur pa u vërejtur nga Inspektorati Policor, për këtë Inspektorati fton qytetarët për bashkëpunim.

Raporti ka bërë një analizë reale, nisur nga fakti që Inspektorati ka analizuar proceduar e marra nga momenti kur Policia e Kosovës ka marrë informatën për mbajtjen protestës, mënyrës si është analizuar niveli dhe shkalla e rrezikshmërisë, është bërë vlerësim i mirë nga Inspektorati për menaxhimin e personelit të Policisë së Kosovës, shpërndarja e tyre, ndarja e detyrave, menaxhimi me mjete dhe materiale

Në Raport janë të përfshira katër raste, për të cilat edhe ne si anëtar të Komisionit kemi njohuri por mungojnë disa raste që nuk janë trajtuar nga Inspektorati Policor, sidomos rastet e paraqitura në Media dhe për këto raste Inspektorati Policor duhet të insistoj që ti paraqes, sidomos gjatë transportimit të arrestuarve nga vendi ku janë mbajt protestuesit deri në stacionet policore.

Inspektorati Policor në raport ka tërhequr vërejtjen për koordinimin e punës me zinxhirin komandues duke theksuar që nuk u është dhënë kohë e mjaftueshme Drejtorive regjionale për hartimin e planeve operative dhe që kohe pas kohe ka pasur shpëputje të komunikimit dhe në disa raste Komandantët taktik është dashur që të bijë vendime konform situatës së krijuar.

Përmendët fakti që në disa rate Komandantët taktik nuk kanë sjell vendime adekuate për disa momente si pozicionim, përdorimin e gazit lotsjellës gjithashtu ka vërejtje për teknikat e arrestimit, gjithashtu në Raport është përmendur edhe përfshirja e personelit që nuk është i trajnuar për menaxhimin e situatave të tilla dhe kërkohet trajnimi shtesë i tyre.

Pas një studimi dhe analize të këtij Raporti do të dalim me rekomandime bazuar edhe palnin e veprimit për mbikëqyrjen e Ligjit për Inspektoratin Policor. Vlerësoj që Inspektorati Policor ka bërë një punë serioze dhe inkurajoj të vazhdoj tutje pasi kjo është në të mirë të Policisë së Kosovës dhe të shoqërisë në tërësi.

Goran Marinković- Vlerësoj që Raporti është i gjerë dhe kronologjik dhe mund të themi që situata e zhvilluar ka qenë serioze, bazuar edhe në pikat të përfshira në Raportin e Inspektoratit Policor, pika 3,4 dhe 15.

Gjatë protestës protestuesit kanë shprehur pakënaqësitë e tyre, policia ka reaguar ndaj protestuesve dhe çfarë është më e rëndësishme janë shmangur konfliktet etnike. Nga Raporti shihet që ka pasur tejkalim të kompetencave nga Policia e Kosovës por në përgjithësi Policia është tregua profesionale në kryerjen e punës së saj gjatë kësaj proteste.

Vjollca Krasniqi- Vlerësimin e performancës për Policinë e Kosovës për protestat e 14 janarit 2012 e kemi bërë në mbledhjet e kaluara kjo pasi të ftuar e kemi pasur Kryeshefin e Inspektoratit Policor. Në raport disa veprime të Policisë konsiderohen si tejkalime të kompetencave të Policisë së Kosovës.

Bazuar në Raportin e Inspektoratit Policor vërehet që ka munguar koordinimi në zinxhirin komandues të Policisë së Kosovës. Rekomandimet e Inspektoratit Policor do të shërbejnë për një performancë më të mirë të Policisë së Kosovës si deh do të plotësohen me rekomandimet që do të dalin nga Komisioni.

Në rekomandimet e përmendura në Raport janë se njësitë e veçanta nuk janë të trajnuara mjaftueshëm për tu përballur me turma, pajisjet jo të mjaftueshme për përballjen e turmave të tilla. Mendoj që duhet bërë akoma punë nga Policia e Kosovës për tu përballur me turma të tilla.

Numri i madh i protestuesve dhe i policëve në këtë protestë, por numri i vogël i Inspektorëve të Inspektoratit Policor gjatë kësaj proteste ka bërë që mos të jenë të pranishëm në çdo situata, dhe mendoj që është dashur të jetë më i madh numri i Inspektorëve në këtë protestë. Vlerësoj Raportin dhe mendoj që ka përfshirë ngjarjet në mënyrë të vazhdueshme.

Nënkryetari i Komisionit- Komisioni bëri vlerësimin e nevojshëm të Raportit të Inspektoratit Policor të Kosovës për kryerjen e detyrave të Policisë së Kosovës me 14 janar 2012 gjatë protestës së organizuara nga Lëvizja Vetëvendosje.

Rekomandimet e Komisionit për këtë Raport dhe me mbikëqyrjen e Ligjit të Inspektoratit Policor do të jenë rekomandime që do të shërbejnë Inspektoratit Policor të Kosovës. Vlerësimi nga anëtarët për Raportin është esencial dhe më tej mbikëqyrja ndaj këtij institucioni do të jetë produktive edhe për të. Theksoj edhe një herë që krahas numrit të vogël të Inspektorëve Policor në Protestë në raport nuk është mbuluar pjesa ku i referohet mënyrës së trajtimit të arrestuarve gjatë transportit deri tek stacionet policore. Ju falënderoj për kontributin e dhënë në këtë analizë dhe do të mbetet që të jepen rekomandime për këtë Raport të Inspektoratit Policor.

4. Të ndryshme

Nënkryetari i Komisionit- Pyeti të pranishmit nëse kanë çështje për të shtruar në këtë pikë.

Goran Marinkovič- Dua të ju njoftoj që për arsye personale nuk mund të jem në vizitën studimore të Komisionit në Gjermani të paraparë për 25 mars 2012 deri më 31 mars 2012.

Nënkryetari i Komisionit- Vizita e Komisionit në Gjermani është ndër më të rëndësishmet e këtij viti, por gjithsesi për arsyet personale vlerëson gjithsecili arsyeshmërinë e mos ardhjes në këtë vizitë.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi